



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministarke Pravde - Office of the Minister of Justice

Prishtinë, 19.09.2023

UDHËZUES PËR ODËN E PËRMBARUESVE PRIVAT TË KOSOVËS

Ministria e Drejtësisë, duke u bazuar në Shtojcën 1, pika 3 të Rregullores (QRK) - NR. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe në thirrjen publike të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, të datës 07.08.2023, për ndërtimin ose renovimin e shtëpive/banesave për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në komuna për të cilët ndihma është e nevojshme, financiar nga masat e mbështetjes LOT 1 dhe LOT 2, për qytetarët në gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale, si dhe të cilët nuk kanë kushte adekuate të banimit, lëshon udhëzuesin si në vijim:

1. Udhëzohen zyrat e përmbaruesve privat që në pajtim me situatën faktike, të shqyrtojnë mundësitë për lehtësimin e pagesave nga llogaritë e bllokuara të debitorëve - përfitues të thirrjes publike të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për ndërtimin ose renovimin e shtëpive/banesave për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në komuna për të cilët ndihma është e nevojshme (përmes zhbllokimit të përkohshëm të llogarive të bllokuara të debitorëve në rastet kur të njëjtit pranojnë mjete financiare subvencionuese të destinuar për ndërtimin ose renovimin e shtëpive/banesave me qëllim të tërheqjes së këtyre mjeteve deri në vlerën e destinuar për këtë qëllim).
2. Ky udhëzues në asnjë rrethanë nuk synon ta cenojë pavarësinë ligjore dhe profesionale të përmbaruesve privat, por ka për qëllim të udhëzojë për veprime të duhura në situatën aktuale sa i përket ndërtimit ose renovimit të shtëpive/banesave për pjesëtarët e komuniteteve jo shumicë në komuna për të cilët ndihma është e nevojshme.

